

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Për ngritjen dhe funksionimin e institucionit publik të arsimit të mesëm të lartë, “Liceu Francez i Korçës””
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Arsimit
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Jo e zbatueshme
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Vendimi nr. 621, datë 22.10.2021 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e saj”
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	10.03.2026 - 10.04.2026
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	____.____.2026
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Po, 26.03.2026
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2026 – MA – Nr. 1
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Mirela Cami, Mirela.Cami@arsimi.gov.al Nr. tel: 0672009572 Shkëlqim Allkaj,

Shkelqim.Allkaj@arsimi.gov.al
Nr. tel: 0695227100
Mirela Bimo
Mirela.Bimo@arsimi.gov.al
Nr. tel.: 067268674
Voltisa Koçi
Voltisa.Koci@arsimi.gov.al
Nr.tel.: 0684325753

PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

(Maksimumi 2 faqe)

PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT

Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja e qeverisë?

Problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij.

Ideja e hapjes së institucionit publik të arsimit të mesëm të lartë publik “Liceu Francez” Korçë, ka lindur si pasojë e kërkesave dhe sfidave të shekullit XXI, për të formuar të rinj të aftë për të sjellë ndryshim dhe inovacion dhe në kuadër të mbështetjes së shkollave të mesme të seksioneve dygjuhëshe shqiptaro-franceze në Republikën e Shqipërisë, me qëllim forcimin e shkëmbimeve kulturore, historike dhe gjuhësore midis dy vendeve, duke nxitur parimet e hapjes, diversitetit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar. Mësimdhënia dhe të nxëniet e gjuhëve të huaja në arsimin parauniversitar përbëjnë një nga shtyllat kryesore të politikave arsimore të Ministrisë së Arsimit. Gjuhët e huaja kontribuojnë drejtpërdrejt në formimin e qytetarëve aktivë, të hapur ndaj diversitetit kulturor dhe të përgatitur për mobilitet arsimor e profesional, si dhe për integrim në tregun e punës. Mësimi i gjuhëve të huaja në arsimin parauniversitar i referohet drejtpërdrejt rekomandimeve dhe standardeve të Këshillit të Evropës dhe bazohet në Kuadrin e Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët, duke reflektuar qasjen bashkëkohore evropiane ndaj edukimit gjuhësor. Kjo qasje fokusohet në zhvillimin e kompetencave dhe në përdorimin funksional të gjuhës në situata reale komunikimi, në funksion të nevojave akademike, sociale dhe profesionale të nxënësve. Në sistemin arsimor shqiptar parauniversitar, prej më se dy dhjetëvjeçarësh, ekzistojnë tri seksione dygjuhëshe shkollorë: shqiptare-franceze, shqiptare-italiane dhe shqiptare-gjermane. Seksionet dygjuhëshe shkollorë janë modeli i një nxënieje jo vetëm dygjuhëshe, por dhe dykulturore në sistemin tonë arsimor

parauniversitar dhe shërbejnë si model i edukimit shumëgjuhësor dhe ndërkulturor. Krahas seksioneve dy gjuhëshe kanë funksionuar me sukses edhe Shkolla e Orientuar Austriake për Teknologjinë e Informacionit “Peter Mahringer” në Shkodër, seksioni shqiptaro-gjerman që funksionon në gjimnazin “Sami Frashëri” në Tiranë, të cilat kanë program dhe kurrikula të përbashkëta me shtetet respektive dhe nxënësve që mbarojnë këto shkolla u njohën studimet drejtpërdrejtë në vendet respektive që mbështesin këto shkolla.

Në këtë prespektivë, krahas kontekstit historiko-shoqëror hapja e një shkolle franceze me drejtim në fushën e TIK, ku nxënësit kanë mësim të gjuhës frënge si gjuhë e huaj bazë në këtë shkollë, marrin edhe njohuri teknike në teknologji dhe inovacion dhe krijojnë mundësi për tu arsimuar më tej dhe integruar më lehtë në tregun shqiptar dhe evropian të punës.

Ministria e Arsimit ka marrë parasysh vizitën e frytshme zyrtare në tetor 2023, të Z. Macron, Presidentit të Republikës së Francës në Shqipëri, të cilit iu bë me dije dëshira e qytetarëve të Korçës për rihapjen e Liceut francez në Korçë, si një simbol historik i bashkëpunimit kulturor dhe arsimor midis Francës dhe Shqipërisë. Ky akt, i pritur me vëmendje nga presidenti francez, i hap rrugën një dialogu më të strukturuar mbi këtë çështje. Në përgjigje të këtij mobilizimi qytetar, iu dërgua një letër autoriteteve franceze, duke riafirmuar angazhimin e qeverisë shqiptare për hapjen e këtij institucioni dhe me mbështetjen e përfaqësisë diplomatike, iu kërkua ndihmë një Eksperti Teknik Ndërkombëtar, i ngarkuar me kryerjen e një studimi paraprak për të planifikuar këtë projekt ambicioz. Kjo dëshmon për një mbështetje konkrete të projektit dhe një përkushtim të ripërtëritë ndaj zhvillimit të frankofonisë në Shqipëri.

Përtej rëndësisë së tij simbolike, ky projekt përfaqëson një angazhim konkret për të promovuar vlerat e ekselencës në arsim, hapjes ndërkombëtare dhe frankofonisë. Historikisht, Liceu francez i Korçës ka kontribuar në formimin e brezave të shqiptarëve që kanë luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin intelektual dhe kulturor të vendit. Rilindja e tij, mbështetur nga angazhimi i qeverive shqiptare dhe franceze, si dhe nga një mobilizim i rëndësishëm lokal, përbën një mundësi unike për t’iu përgjigjur sfidave arsimore aktuale, duke ruajtur njëkohësisht këtë trashëgimi të çmuar.

Propozimi vjen edhe në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga ligji kuadër nr. 64/2024 “Për ratifikimin e Marrëveshjes Ndërqeveritare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Francës për kontributin në zbatimin e projekteve prioritare në Shqipëri” ku përcaktohet angazhimi për identifikimin dhe zbatimin e projekteve prioritare strategjike në sektorë të ndryshëm përfshirë turizmin, menaxhimin e ujit, mjedisin, inovacionin, digjitalizimin, energjinë, reformën në administratën publike, transportin, arsimin, shëndetësinë dhe bujqësinë, që kanë si qëllim transferimin e teknologjisë dhe zhvillimin profesional të fuqisë punëtore, që do të kontribuojë në përgatitjen e Shqipërisë për anëtarësimin në BE. Palët për arritjen e këtij qëllimi do të ndajnë informacionin përkatës për këto projekte dhe do të identifikojnë financimin për të mbështetur zbatimin e tyre.

Konkretisht në nenin 2 të këtij ligji përcaktohen mënyrat prioritare të bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Francës për kontributin në zbatimin e projekteve prioritare në Shqipëri siç janë nxitja e bashkëpunimit në fushën e arsimit parauniversitar, përfshirë arsimin dhe formimin profesional (VET/AFP), arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor; nxitja për hapjen dhe funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitar franceze në Republikën e Shqipërisë, institucioneve franceze të arsimit të lartë ose të degëve të tyre, modalitetet e organizimit dhe veprimtarisë e të cilave do të përcaktohen në aktet përkatëse të hapjes, ku sipas rastit do të ndiqen procedurat e brendshme të ratifikimit, bazuar në legjislacionin në fuqi, duke përfshirë hapjen e programeve të përbashkëta të studimit në institucionet përkatëse të arsimit të lartë të të dyja vendeve.

Ideja për ngritjen dhe funksionimin e Liceut Francez të Korçës përbën një politikë të rëndësishme arsimore për hapjen e institucionit publik të arsimit të mesëm të lartë, duke garantuar koherencë, qëndrueshmëri dhe efektivitet në zhvillimin e aftësive të nxënësve në arsimin parauniversitar dhe veçanërisht në fushën e të nxënësve në shkenca dhe inovacion.

Me anë të kësaj politike arsimore synohet të mbështetet zhvillimi dhe fuqizimi i aftësive të nxënësve në shkenca dhe inovacion duke përforcuar njëkohësisht zotërimin e ekuilibruar të disa gjuhëve të huaja, si dhe duke garantuar një përgatitje optimale për arritjen e standardeve ndërkombëtare në arsimin e mesëm të lartë dhe tregun ndërkombëtar të punës.

Nëpërmjet hapjes së institucionit publik të arsimit të mesëm të lartë "Liceu Francez" Korçë, synohet gjithashtu përtëritja e traditës së bashkëpunimit arsimor shqiptaro-francez të shkollës së mesme kombëtare (e njohur si "Liceu francez") i Korçës (1917-1939).

Pse është e nevojshme ndërhyrja e qeverisë?

Ndërhyrja qeveritare është thelbësore për të:

- promovuar vlerat e ekselencës në arsim, hapjes ndërkombëtare dhe frankofonisë. Historikisht, Liceu francez i Korçës ka kontribuar në formimin e brezave të shqiptarëve që kanë luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin intelektual dhe kulturor të vendit. Rilindja e tij, mbështetur nga angazhimi i qeverive shqiptare dhe franceze, si dhe nga një mobilizim i rëndësishëm lokal, përbën një mundësi unike për t'iu përgjigjur sfidave arsimore aktuale, duke ruajtur njëkohësisht këtë trashëgimi të çmuar;
- përmbushur kërkesat dhe sfidat e shekullit XXI, për të formuar të rinj të aftë për të sjellë ndryshim dhe inovacion dhe në kuadër të mbështetjes së shkollave të mesme të seksioneve dygjuhëshe shqiptaro-franceze në Republikën e Shqipërisë, me qëllim forcimin e shkëmbimeve kulturore, historike dhe gjuhësore midis dy vendeve, duke nxitur parimet e hapjes, diversitetit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar;

- garantuar koherencë, qëndrueshmëri dhe efektivitet në zhvillimin e aftësive të nxënësve në arsimin parauniversitar dhe veçanërisht në fushën e të nxënësve në shkencë dhe inovacion;
- synuar gjithashtu përtëritjen e traditës së bashkëpunimit arsimor shqiptaro-francez të shkollës së mesme kombëtare (e njohur si "Liceu francez") i Korçës (1917-1939);
- zgjeruar mundësitë e nxënësve për të ndjekur një institucion arsimor publik konkurrues me kurrikul bashkëkohore që ofron mësim në gjuhën frënge, shqipe dhe angleze dhe synon aftësimin dhe zhvillimin intelektual të nxënësve në fushën e të nxënësve në shkencë dhe inovacion që përbën një fushë shumë të kërkuar dhe bashkëkohore për gjeneratën e grup moshës që do të ndjekë këtë shkollë publike;
- kontribuar në modernizimin e sistemit arsimor parauniversitar dhe përafrimin me standardet evropiane, ofrimin e një certifikimi të dyfishtë, të bazuar në programet franceze dhe shqiptare, duke u mundësuar nxënësve pajisjen me diplomën e Maturës Shtetërore shqiptare, ashtu edhe me diplomën franceze *Baccalauréat*;
- integruar teknologjitë e reja në procesin mësimor me qëllim zhvillimin e aftësive të avancuara digjitale dhe përgatitjen e nxënësve për t'u përshtatur me sfidat e një bote të globalizuar.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

Ky propozim synon të përcaktojë kuadrin ligjor për ngritjen, funksionimin dhe administrimin e institucionit publik të arsimit të mesëm të lartë, Liceu Francez i Korçës (në vijim Liceu), i orientuar në fushën e të nxënësve në shkencë dhe inovacion, që ushtron veprimtarinë në qytetin e Korçës. Qëllimi i këtij propozimi është të sigurojë një qasje rajonale dhe ndërkombëtare, duke zhvilluar partneritete arsimore, kulturore, shkencore franko-shqiptare, si dhe të vazhdojë traditën e bashkëpunimit arsimor frankofon të Liceut të Korçës.

Objektivat e tij kryesorë janë:

- Të mbështetet zhvillimi dhe fuqizimi i aftësive të nxënësve në shkencë dhe inovacion duke përforcuar njëkohësisht zotërimin e ekuilibruar të disa gjuhëve të huaja, si dhe duke garantuar një përgatitje optimale për arritjen e standardeve ndërkombëtare në arsimin e mesëm të lartë dhe tregun ndërkombëtar të punës.
- Të ndërtojë një model bashkëpunimi ndërkombëtar në arsim përmes partneriteteve me shkolla dhe universitete franceze dhe programeve të përbashkëta.

- Të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet sigurimit të standardeve të larta pedagogjike dhe zbatimit të metodave moderne të mësimdhënies.
- Të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë në Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematikë/*Science, Technology, Engineering and Mathematics* (STEM) përmes zhvillimit të kompetencave të nxënësve në matematikë, shkencë natyrore, teknologji dhe inovacion për t'i përgatitur për studime universitare dhe tregun e punës të së ardhmes.
- Të forcojë bashkëpunimin në arsim dhe kulturë midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Francës përmes një modeli arsimor bazuar në praktikën më të mirë franceze dhe të forcohen marrëdhëniet në fushën e arsimit dhe ato kulturore mes dy vendeve.
- Të krijojë një model modern dhe inovativ të arsimit parauniversitar në Shqipëri, një institucion që promovon metoda bashkëkohore të mësimdhënies dhe përdorimin e teknologjisë.
- Të nxisë inovacionin, kreativitetin dhe mendimin kritik të rinjtë përmes një mjedisi që stimulon aftësinë për të krijuar zgjidhje inovative për sfidat e shoqërisë dhe ekonomisë moderne.

Objektivat kryesore

1. Të zhvillohen kompetencat në lëndët STEM dhe inovacion.

- Të fuqizohen aftësitë e nxënësve në matematikë, shkencë natyrore, teknologji dhe inovacion, përmes një kurrikule të avancuar dhe të orientuar drejt kërkimit dhe zgjidhjes së problemeve.
- Të përgatiten nxënësit për studime universitare në fusha shkencore dhe teknologjike, duke i aftësuar për sfidat e ekonomisë së dijes dhe të tregut të punës të së ardhmes.
- Të zhvillohet mendimi kritik, kreativiteti dhe kultura e inovacionit përmes projekteve kërkimore, laboratorëve shkencorë dhe aktiviteteve ndërlëndore.

2. Të forcohet arsimi shumëgjuhësh dhe ndërkombëtarizimi i të nxënësve

- Të ofrohet një model arsimor shumëgjuhësh, ku procesi mësimor zhvillohet në gjuhën shqipe, frënge dhe angleze, duke garantuar kompetencat të avancuara gjuhësore për nxënësit.
- Të promovohet kultura frankofone dhe bashkëpunimi ndërkombëtar në arsim përmes partneriteteve me institucione arsimore dhe universitare në Francë dhe në vende të tjera frankofone.

3. Të sigurohet një diplomë e dyfishtë e njohur ndërkombëtarisht

- Të mundësohet një certifikim i dyfishtë, duke u ofruar nxënësve mundësinë të pajisen njëkohësisht me Diplomën e Maturës Shtetërore shqiptare dhe me diplomën franceze Baccalauréat, e njohur në një numër të madh vendesh.

- Të lehtësohet aksesimi i nxënësve në universitete prestigjioze ndërkombëtare dhe në programe studimi jashtë vendit.
- 4. Të fuqizohet lidhja e arsimit me tregun ndërkombëtar të punës**
- Të zhvillohen kompetenca të transferueshme dhe aftësi të avancuara që kërkohen në tregun global të punës, si mendimi kritik, zgjidhja e problemeve komplekse, bashkëpunimi dhe inovacioni.
 - Të krijohet ura bashkëpunimi me universitete, institucione kërkimore dhe sektorë të ekonomisë për të përgatitur nxënësit për profesionet e së ardhmes.
- 5. Të sigurohet cilësi e lartë në procesin e mësimdhënies -nxënies**
- Të garantohen standarde të larta pedagogjike përmes angazhimit të një stafi mësimor të specializuar dhe të trajnuar, në përputhje me praktikën më të mirë të sistemeve arsimore shqiptare dhe franceze.
 - Të zbatohen metoda bashkëkohore të mësimdhënies, të bazuara në të nxënësit aktiv, kërkimin shkencor dhe përdorimin e teknologjive digjitale në procesin mësimor.
- 6. Të forcohet bashkëpunimi arsimor dhe kulturor shqiptaro-francez**
- Të forcohen marrëdhëniet arsimore dhe kulturore ndërmjet Shqipërisë dhe Francës përmes një modeli bashkëpunimi të qëndrueshëm institucional.
 - Të kontribuohet në zhvillimin dhe promovimin e frankofonisë në sistemin arsimor shqiptar.

Për të realizuar objektivat si më sipër, do të ndërmerren disa masa, konkretisht:

- Krijimi i një strukture organizative dhe pedagogjike të përshtatshme, për funksionimin e Liceut Francez, me ndikim pozitiv në sistemin arsimor.
- Pajisja e liceut me laboratorë modernë për fizikë, kimi, biologji, informatikë dhe mundësi të zhvillimit të projekteve dhe eksperimenteve shkencore dhe inovative nga nxënësit.
- Organizimi i programeve të shkëmbimit për nxënës dhe mësues me institucione arsimore franceze si dhe zhvillimi i projekteve të përbashkëta shkencore dhe kulturore me shkollat dhe universitetet në Francë.
- Organizimi i aktiviteteve kulturore, shkencore dhe edukative që promovojnë gjuhën dhe kulturën frankofone.
- Zbatimi i metodave bashkëkohore pedagogjike, promovimi i të nxënësit aktiv dhe nxitja e kulturës së kërkimit dhe inovacionit
- Sigurimi i zhvillimit profesional të mësuesve dhe pjesëmarrja në rrjete dhe programe ndërkombëtare të arsimit frankofon.
- Zhvillimi i bashkëpunimeve me institucione arsimore dhe kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare për shkëmbimin e praktikave më të mira me institucione të tjera arsimore në vend.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të disavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Opsionet e mëposhtme janë vlerësuar në funksion të arritjes së objektivave të politikave:

1. Opsioni 0: – status quo-ja : - Të vijohet me kuadrin ligjor ekzistues, ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Pra ruajtja e “status quo”-së (duke mosndërhyrë me amendime të mëtejshme, në kuadrin ligjor në fuqi dhe duke mos hartuar një projektligj të ri) nuk do të siguronte një qasje rajonale dhe ndërkombëtare, duke zhvilluar partneritete arsimore, kulturore, shkencore franko-shqiptare, si dhe të vazhdojë traditën e bashkëpunimit arsimor frankofon të Liceut të Korçës. Ngritja e një institucioni arsimor publik në bazë të ligjit në fuqi nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar nuk do të garantonte autonomi administrative dhe financiare, siç synohet të ketë Liceu Francez i Korçës.

Nëse zgjidhet ky opsion, nuk do të ketë mundësi për ngritjen dhe funksionimin e Liceut Francez të Korçës, duke ruajtur varësinë nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe duke vazhduar funksionimin sipas dispozitave ekzistuese. Status quo-ja nuk adreson sfidat e identifikuara në raport me efikasitetin, cilësinë dhe autonominë institucionale dhe nuk krijon hapësirë për zhvillim të mëtejshëm ekonomik, organizativ apo për përmirësim të performancës institucionale.

Kjo alternativë konsiston në krijimin e një programi të specializuar shkencor dhe dygjuhësh brenda një gjimnazi ekzistues publik, duke përdorur infrastrukturën dhe strukturën administrative të institucionit aktual. Avantazhi kryesor i kësaj alternative lidhet me kostot më të ulëta fillestare, pasi nuk kërkohet krijimi i një institucioni të ri dhe mund të përdoret infrastruktura ekzistuese shkollore. Në këtë mënyrë do të reduktoheshin investimet fillestare për pajisje dhe mobilim, si dhe një pjesë e kostove administrative. Megjithatë, analiza tregon se kjo alternativë ka disa kufizime të rëndësishme strukturore.

Së pari, një gjimnaz ekzistues funksionon sipas rregullave të zakonshme të sistemit të arsimit parauniversitar dhe nuk ka fleksibilitetin institucional për të implementuar një model të plotë ndërkombëtar të arsimit të mesëm. Integrimi i një programi të avancuar dygjuhësh në një strukturë ekzistuese mund të krijojë vështirësi organizative dhe pedagogjike.

Së dyti, infrastruktura e gjimnazeve aktuale nuk është projektuar për modele të avancuara laboratorike dhe teknologjike, të cilat janë një komponent thelbësor i projektit të liceut. Për pasojë, do të kërkoheshin ndërhyrje të konsiderueshme në infrastrukturë dhe pajisje, të cilat do të reduktonin ndjeshëm avantazhin financiar fillestar të kësaj alternative.

Së treti, integrimi i një programi ndërkombëtar në një institucion ekzistues do të kufizonte autonominë akademike dhe administrative të programit dhe do të vështirësonte bashkëpunimin institucional me partnerët ndërkombëtarë.

Në këtë kuadër, megjithëse kjo alternativë paraqet një kosto më të ulët fillestare, ajo nuk garanton krijimin e një modeli të plotë dhe të qëndrueshëm të arsimit ndërkombëtar të mesëm.

Opsioni 1: – Ndryshimi i kuadrit rregullator në fuqi për të krijuar mundësinë e ngritjes dhe funksionimit të Liceut Francez të Korçës.

Ndryshimi i kuadrit rregullator ekzistues nuk do të sillte mundësinë e krijimit të Liceut Francez të Korçës. Mënyra e saj e re konceptuale e organizimit dhe funksionimit të Liceut Francez të Korçës duhet të jetë e rregulluar me një ligj të posaçëm, me qëllim krijimin e një modeli modern dhe inovativ të arsimit parauniversitar në Shqipëri, një institucion që promovon metoda bashkëkohore të mësimdhënies dhe përdorimin e teknologjisë, që përcjell një mënyrë të re organizimi, administrimi dhe financimi.

Miratimi i një ligji të veçantë është i nevojshëm pasi Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” rregullon organizimin e përgjithshëm të institucioneve të arsimit parauniversitar dhe nuk parashikon modele të veçanta institucioneve me administrim të përbashkët ndërkombëtar dhe kurrikulë të dyfishtë. Liceu Franko-Shqiptar parashikon një strukturë të veçantë drejtimi me përfshirjen e autoriteteve franceze, zhvillimin e mësimin në disa gjuhë dhe zbatimin e një kurrikule të integruar që çon në dy diploma shtetërore. Këto elemente kërkojnë rregullime specifike për organizimin, financimin, rekrutimin e personelit të huaj dhe njohjen e dokumenteve shkollore, të cilat nuk parashikohen nga kuadri aktual ligjor. Për këtë arsye është e nevojshme një ligj i posaçëm që të përcaktojë statusin dhe funksionimin e këtij institucioni.

Opsioni 2 (i preferuar): – Hartimi i një ligji të posaçëm për ngritjen dhe funksionimin e Liceut.

Alternativa e tretë konsiston në krijimin e një institucioni të ri publik, Liceut Francez të Korçës për Shkencat dhe Inovacionin, i cili do të funksionojë si një shkollë e specializuar me profil shkencor dhe me model pedagogjik dygjuhësh.

Kjo alternativë mundëson ndërtimin e një strukture institucionale të dedikuar për realizimin e objektivave të projektit dhe garanton një organizim të pavarur pedagogjik dhe administrativ.

Një institucion i ri lejon krijimin e një modeli të integruar arsimor që përfshin laboratorë të avancuar shkencorë, hapësira inovacioni dhe një strukturë pedagogjike të orientuar drejt fushave STEM. Gjithashtu, kjo alternativë krijon kushte më të favorshme për bashkëpunim institucional me partnerët ndërkombëtarë dhe për integrimin e praktikave pedagogjike të sistemit arsimor francez.

Nga pikëpamja financiare, kjo alternativë kërkon investime më të mëdha fillestare dhe një nivel më të lartë të kostove operative në krahasim me alternativën e integrit të programit në një gjimnaz ekzistues. Megjithatë, analiza tregon se këto kosto lidhen drejtpërdrejt me standardin e lartë të arsimit që synon të ofrojë institucioni dhe me komponentët ndërkombëtarë të programit.

Gjithashtu, krijimi i një institucioni të ri mundëson zhvillimin e një modeli pilot për arsimin shkencor dhe inovativ në Shqipëri, i cili mund të shërbejë si referencë për zhvillimin e politikave të ardhshme në sistemin arsimor.

Nga analiza e kryer rezulton se alternativa e krijimit të një institucioni të ri publik me model ndërkombëtar paraqet potencialin më të madh për realizimin e objektivave të projektit dhe për zhvillimin e një modeli të qëndrueshëm të arsimit të mesëm me standarde ndërkombëtare në Shqipëri. Megjithatë kjo alternativë kërkon një nivel më të lartë investimi fillestar dhe kostosh operative, përfitimet afatgjata në aspektin e cilësisë së arsimit, bashkëpunimit ndërkombëtar dhe zhvillimit të kapaciteteve shkencore e bëjnë atë alternativën më të përshtatshme për realizimin e objektivave të projektligjit.

Nga analiza rezulton se **alternativa e tretë** ofron potencialin më të madh për arritjen e objektivave strategjike të projektit.

Analiza financiare parashikon një rritje progresive të kostove gjatë pesë viteve të para të funksionimit të institucionit.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Ndikimet ekonomike:

Opsioni 2 – Krijimi i një institucioni të ri me model ndërkombëtar

Alternativa e tretë konsiston në ngritjen dhe funksionimin e një institucioni të ri publik, Liceut Francez të Korçës, i cili do të funksionojë si një shkollë e specializuar me profil shkencor dhe me model pedagogjik dygjuhësh.

Kjo alternativë mundëson ndërtimin e një strukture institucionale të dedikuar për realizimin e objektivave të projektit dhe garanton një organizim të pavarur pedagogjik dhe administrativ.

Një institucion i ri lejon krijimin e një modeli të integruar arsimor që përfshin laboratorë të avancuar shkencorë, hapësira inovacioni dhe një strukturë pedagogjike të orientuar drejt fushave STEM. Gjithashtu, kjo alternativë krijon kushte më të favorshme për bashkëpunim institucional me partnerët ndërkombëtarë dhe për integrimin e praktikave pedagogjike të sistemit arsimor francez.

Nga pikëpamja financiare, kjo alternativë kërkon investime më të mëdha fillestare dhe një nivel më të lartë të kostove operative në krahasim me alternativën e integrit të programit në një gjimnaz ekzistues. Megjithatë, analiza tregon se këto kosto lidhen drejtpërdrejt me standardin e lartë të arsimit që synon të ofrojë institucioni dhe me komponentët ndërkombëtarë të programit.

Gjithashtu, krijimi i një institucioni të ri mundëson zhvillimin e një modeli pilot për arsimin shkencor dhe inovativ në Shqipëri, i cili mund të shërbejë si referencë për zhvillimin e politikave të ardhshme në sistemin arsimor.

Nga analiza e kryer rezulton se alternativa e krijimit të një institucioni të ri publik me model ndërkombëtar paraqet potencialin më të madh për realizimin e objektivave të projektit dhe për zhvillimin e një modeli të qëndrueshëm të arsimit të mesëm me standarde ndërkombëtare në Shqipëri. Megjithëse kjo alternativë kërkon një nivel më të lartë investimi fillestar dhe kostosh operative, përfitimet afatgjata në aspektin e cilësisë së arsimit, bashkëpunimit ndërkombëtar dhe zhvillimit të kapaciteteve shkencore e bëjnë atë alternativën më të përshtatshme për realizimin e objektivave të projektligjit.

Nga analiza rezulton se alternativa e tretë ofron potencialin më të madh për arritjen e objektivave strategjike të projektit.

Analiza financiare parashikon një rritje progresive të kostove gjatë pesë viteve të para të funksionimit të institucionit.

Tregues kryesorë

Treguesi	Vlera
Kapaciteti maksimal i liceut	360 nxënës
Numri i klasave	12 klasa
Kosto mesatare për nxënës	rreth 8,800 € / vit
Kosto mesatare për klasë	rreth 266,000 € / vit
Kosto mesatare vjetore për buxhetin e shtetit (5 vitet e para)	rreth 2.15 milion €

Investimi fillestar

Zëri	Vlera e vlerësuar
Pajisje laboratorike dhe STEM	800,000 – 1,000,000 €
Pajisje digjitale dhe IT	300,000 – 400,000 €
Mobilim dhe pajisje pedagogjike	400,000 – 500,000 €
Pajisje mediateke dhe hapësira inovacioni	200,000 – 400,000 €

Totali i investimit fillestar	1.7 – 2.3 milion €
-------------------------------	--------------------

Tabela e RIA – Ndikimi financiar i projektligjit

Viti	Numri i nxënësve	Kosto totale e projektit (€)	Kontributi i palës franceze (drejtori) (€)	Kosto neto për buxhetin e shtetit (€)	Kosto për nxënës (€)
Viti 1	120	1,123,143	115,200	1,007,943	8,399
Viti 2	200	1,675,852	117,000	1,558,852	7,794
Viti 3	280	2,574,031	118,800	2,455,231	8,769
Viti 4	320	2,761,221	120,600	2,640,621	8,252
Viti 5	360	3,197,204	122,500	3,074,704	8,541
Totali 5 vite	—	11,331,451	~594,000	~10,737,000	—

Krahasimi me një gjimnaz publik shqiptar

Tregues	Gjimnaz publik shqiptar	Liceu Franko-Shqiptar
Numri i nxënësve	360	360
Kosto vjetore totale	≈ 648,000 €	≈ 3,197,000 €
Kosto për nxënës	≈ 1,800 €	≈ 8,400 €
Kosto për klasë	≈ 54,000 €	≈ 266,000 €

Kostoja për nxënës në Liceun Francez të Korçës është rreth 4.5 – 5 herë më e lartë se në një gjimnaz publik standard, për shkak të:

- modelit dygjuhësh dhe ndërkombëtar të arsimit,
- stafit pedagogjik ndërkombëtar,
- laboratorëve shkencorë dhe pajisjeve STEM,
- strukturës së zgjeruar pedagogjike dhe të jetës shkollore.

Investimi fillestar (RIA)

Kategoria	Vlera e vlerësuar
Pajisje laboratorike dhe STEM	800,000 – 1,000,000 €
Infrastrukturë digjitale dhe IT	300,000 – 400,000 €
Mobilim dhe pajisje pedagogjike	400,000 – 500,000 €
Pajisje për mediatekë dhe hapësira inovacioni	200,000 – 400,000 €
Totali investimit fillestar	1.7 – 2.3 milion €

Në këtë kuadër, projektligji parashikon që gjatë pesë viteve të para të funksionimit pala franceze të mbulojë kostot që lidhen me pozicionin e drejtorit të liceut, i cili parashikohet të jetë një drejtues me përvojë në sistemin arsimor francez. Kostoja e këtij pozicioni vlerësohet rreth 115 mijë euro në vit, ose rreth 594 mijë euro në pesë vite.

Në këtë mënyrë, kostoja neto për buxhetin e shtetit gjatë pesë viteve të para parashikohet të jetë rreth 10.74 milion euro.

Përveç kostove operative, projekti kërkon edhe një investim fillestar për pajisjet dhe mobilimin e institucionit, i cili vlerësohet mesatarisht 2 milion euro. Në buxhetin e Ministrisë përgjegjëse për arsimin për periudhën 2026-2028 janë planifikuar 100 milion

lekë ose 1 milion euro (përkatësisht 200 mijë euro në buxhetin e vitit 2026 dhe 800 mijë euro në buxhetin e vitit 2027). Në vijim, pajisjet me infrastrukturë digjitale do të sigurohen përmes projektit “Gov tech”.

Gjithashtu në buxhetin e vitit 2026-2028 janë planifikuar edhe fondet për burimet njerëzore për palën shqiptare (pa kostot e mensës dhe konviktit të cilat përballohen nga NJQV, Bashkia Korçë), ku përfshihen paga, kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe shpenzime operative.

Krijimi i liceut nuk kërkon ngritjen e institucioneve të reja shtetërore, por krijimin e një institucioni arsimor publik në varësi të Ministrisë së Arsimit.

Institucioni do të funksionojë në bashkëpunim me:

- Ministrinë e Arsimit;
- institucionet arsimore franceze;
- partnerë që veprojnë në fushën e arsimit.

Projektligji pritet të ketë ndikime pozitive në disa drejtime:

- përmirësimi i cilësisë së arsimit të mesëm në fushat shkencore;
- rritja e mundësive të nxënësve shqiptarë për studime në universitetet europiane;
- zhvillimi i kapaciteteve pedagogjike dhe shkencore në sistemin arsimor shqiptar;
- rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e arsimit.

Institucioni pritet të kontribuojë gjithashtu në zhvillimin ekonomik dhe social të rajonit ku do të vendoset, duke krijuar vende pune dhe duke rritur atraktivitetin akademik të zonës.

Projektligji nuk krijon barriera për biznesin dhe nuk ndikon në konkurrencën në treg.

Ndikimet ekonomike lidhen kryesisht me kontraktimin e shërbimeve dhe furnizimeve për institucionin dhe investimet në infrastrukturë dhe pajisje.

Zbatimi i projektligjit do të monitorohet nga Ministria e Arsimit përmes:

- raportimit vjetor të performancës së institucionit;
- vlerësimin të treguesve të cilësisë së arsimit;
- analizës së ndikimit financiar dhe institucional të projektit.

Pas një periudhe pesëvjeçare të funksionimit do të kryhet një vlerësim i plotë i modelit për të përcaktuar mundësinë e zgjerimit të tij ose të adaptimit të praktikave të suksesshme në institucione të tjera arsimore.

Ndikimet sociale: Ndikimet sociale të këtij ligji lidhen me përmirësimin e rezultateve të nxënësve dhe zgjerimin e mundësive për studentët e ardhshëm të kontribuojnë drejtpërdrejt në krijimin e kushteve më të mira për zhvillimin ekonomik të vendit, me ndikime pozitive në aspektin socio-ekonomik. Institucioni pritet të kontribuojë gjithashtu në zhvillimin ekonomik dhe social të rajonit ku do të vendoset, duke krijuar vende pune dhe duke rritur atraktivitetin akademik të zonës.

Nëprmtjet rritjes së mundësive arsimore për nxënësit, prindërit do të kenë mundësi të regjistrojnë fëmijët në një shkollë publike me standarde ndërkombëtare dhe me diplomë të dyfishtë, pa qenë e nevojshme të largohen nga vendi ose të paguajnë për shkolla të shtrenjta private.

Prania e një institucioni arsimor me profil ndërkombëtar rrit prestigjin arsimor të qytetit të Korçës dhe e kthen atë në një qendër rajonale për arsimin e mesëm cilësor. Bashkëpunimi franko-shqiptar parashikohet të sjellë aktivitete kulturore, shkencore dhe edukative që përfshijnë jo vetëm nxënësit, por edhe prindërit dhe komunitetin lokal.

Ndikimet mjedisore: Opsioni i preferuar krijon impakt lidhur me ndikimet mjedisore, pasi do të ndërtohet infrastruktura për ngritjen dhe funksionimin e Liceut.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Opsioni i preferuar është **Opsioni 2**. Hartimi i një ligji të posaçëm konsiston në krijimin e një institucioni të ri publik, Liceut Francez të Korçës për Shkencat dhe Inovacionin, i cili do të funksionojë si një shkollë e specializuar me profil shkencor dhe me model pedagogjik dygjuhësh.

Kjo alternativë mundëson ndërtimin e një strukture institucionale të dedikuar për realizimin e objektivave të projektit dhe garanton një organizim të pavarur pedagogjik dhe administrativ.

Një institucion i ri lejon krijimin e një modeli të integruar arsimor që përfshin laboratorë të avancuar shkencorë, hapësira inovacioni dhe një strukturë pedagogjike të orientuar drejt fushave STEM. Gjithashtu, kjo alternativë krijon kushte më të favorshme për bashkëpunim institucional me partnerët ndërkombëtarë dhe për integrimin e praktikave pedagogjike të sistemit arsimor francez.

Nga pikëpamja financiare, kjo alternativë kërkon investime më të mëdha fillestare dhe një nivel më të lartë të kostove operative në krahasim me alternativën e integrit të programit në një gjimnaz ekzistues. Megjithatë, analiza tregon se këto kosto lidhen drejtpërdrejt me standardin e lartë të arsimit që synon të ofrojë institucioni dhe me komponentët ndërkombëtarë të programit.

Gjithashtu, krijimi i një institucioni të ri mundëson zhvillimin e një modeli pilot për arsimin shkencor dhe inovativ në Shqipëri, i cili mund të shërbejë si referencë për zhvillimin e politikave të ardhshme në sistemin arsimor.

Nga analiza e kryer rezulton se alternativa e krijimit të një institucioni të ri publik me model ndërkombëtar paraqet potencialin më të madh për realizimin e objektivave të projektit dhe për zhvillimin e një modeli të qëndrueshëm të arsimit të mesëm me standarde ndërkombëtare në Shqipëri. Megjithëse kjo alternativë kërkon një nivel më të lartë investimi fillestar dhe kostosh operative, përfitimet afatgjata në aspektin e cilësisë së arsimit, bashkëpunimit ndërkombëtar dhe zhvillimit të kapaciteteve shkencore e bëjnë atë alternativën më të përshtatshme për realizimin e objektivave të projektligjit.

Kostoja e përlogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Financimi	Viti 1_ 2026	Viti 2_ 2027	Viti 3_2028
Total			
Buxheti i shtetit	0	0	0
Të pambuluara	200	210	215

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsytet pse?)

Në zbatim të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, i cili përcakton rregullat dhe procedurat e njoftimit e të konsultimit publik që zhvillohen nga organet publike në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse, projektligji “Për ngritjen dhe funksionimin e institucionit publik të arsimit të mesëm të lartë, “Liceu Francez i Korçës” është publikuar për konsultim publik në regjistrin elektronik të njoftimeve dhe konsultimeve publike (RENJK), si dhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit më datë 10.03.2026.

Në faqen e Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK) publikimi i projektligjit “Për ngritjen dhe funksionimin e institucionit publik të arsimit të mesëm të lartë, “Liceu Francez i Korçës”” është i aksesueshëm në linkun e mëposhtëm:

<https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Qytetar>

Deri më datë 11.03.2026 numri i shikimeve në RENJK është 255, por nuk është paraqitur asnjë koment.

Afati i mbylljes së publikimit për konsultimin publik është deri më datë 10.04.2026.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Veprimtaria e Liceut Francez të Korçës do të organizohet në përputhje me ligjin për ngritjen dhe funksionimin e Liceut Francez, legjislacionin shqiptar në fuqi në fushën e arsimit dhe me marrëveshjet e bashkëpunimit arsimor ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Franceze, siç janë “Marrëveshja ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë

dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Zhvillimit Ndërkombëtar të Republikës së Francës, mbi bashkëpunimin në fushën e Arsimit Dygjuhësh” dhe “Marrëveshjes Ndërqeveritare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Franceze mbi kontributin në zbatimin e projekteve prioritare në Shqipëri”, e ratifikuar me ligjin nr. 64/2024 “Për ratifikimin e Marrëveshjes Ndërqeveritare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Francës për kontributin në zbatimin e projekteve prioritare në Shqipëri”.

Në kuadër të autonomisë së institucionit, mbikëqyrja e funksionimit të përgjithshëm të Liceut Francez të Korçës, do të kryhet nga Këshilli Administrativ si organi vendimmarrës i Liceut, i cili garanton autonominë e institucionit, zbatimin e parimeve të ligjshmërisë, përgjegjësisë, mbikëqyrjes, paañësisë, objektivitetit dhe transparencës dhe kryesohet nga Ministri përgjegjës për arsimin i Republikës së Shqipërisë ose përfaqësuesi i autorizuar prej tij. Liceu Francez i Korçës do të raportojë periodikisht pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin mbi veprimtarinë e tij, duke përfshirë informacion mbi ecurinë e procesit mësimor, rezultatet e nxënësve dhe çështje të tjera që lidhen me cilësinë e shërbimit arsimor.

Institucionet përgjegjëse për monitorimin dhe inspektimin verifikojnë pajtueshmërinë e veprimtarisë së Liceut me kuadrin rregullator në fuqi, nëpërmjet kryerjes së proceseve të monitorimit dhe të inspektimit.

Kurrikula e zbatuar për lëndët e zhvilluara në gjuhën frënge mbikëqyret nga ministria franceze përgjegjëse për arsimin, ndërsa për lëndët që zhvillohen në gjuhë shqipe dhe angleze mbikëqyret nga institucioni përgjegjës për Sigurimin e Cilësisë së Arsimit Parauniversitar.

Veprimtaria financiare e Liceut i nënshtrohet auditimit dhe kontrollit administrativ e financiar nga autoritetet kompetente, përfshirë institucionet përgjegjëse për arsimin dhe financat publike, sipas legjislacionit në fuqi.

Për realizimin e qëllimeve të tij, Liceu Francez i Korçës bashkëpunon dhe bashkërendon veprimtarinë me ministrinë përgjegjëse për arsimin, institucionet arsimore, autoritetet vendore dhe partnerët ndërkombëtarë në fushën e arsimit, me synim garantimin e cilësisë së arsimit dhe zbatimin e praktikave më të mira arsimore.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

- *Jepni kontekstin e politikës*

Bashkëpunimi ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Franceze në fushën e arsimit ka një traditë të gjatë historike, e cila daton që në fillim të shekullit XX. Një nga shembujt më të rëndësishëm të këtij bashkëpunimi ka qenë funksionimi i Liceut Francez në Korçë, i themeluar në vitin 1917 gjatë periudhës së administrimit francez në qytet. Ky institucion u krijua me qëllimin për të ofruar një arsimim modern sipas modelit francez dhe për të promovuar gjuhën dhe kulturën franceze në Shqipëri.

Liceu Francez i Korçës shpejt u shndërrua në një nga institucionet më prestigjioze arsimore në vend, duke kontribuar në formimin intelektual dhe qytetar të shumë brezave të rinjsh shqiptarë. Programet mësimore dhe metodat pedagogjike të përdorura në këtë institucion u mbështetën në modelin arsimor francez dhe ndikuan ndjeshëm në zhvillimin e arsimit modern në Shqipëri. Gjatë viteve të funksionimit të tij, liceu përgatiti shumë personalitete të shquara të jetës politike, kulturore dhe akademike shqiptare.

Në dekadat e fundit, marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe Francës në fushën e arsimit janë zhvilluar më tej përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit dypalësh, projekteve arsimore të përbashkëta, promovimit të gjuhës frënge dhe mbështetjes së programeve frankofone në institucionet arsimore shqiptare. Në këtë kuadër, rikthimi i një institucioni arsimor që mbart traditën e Liceut Francez në Korçë konsiderohet një hap i rëndësishëm për forcimin e bashkëpunimit arsimor ndërmjet dy vendeve dhe për promovimin e një modeli arsimor bashkëkohor të bazuar në standardet evropiane.

Nisma për krijimin e Liceut Francez në Korçë synon të ndërtojë mbi këtë trashëgimi historike dhe të ofrojë një institucion arsimor cilësor që integron praktikën më të mirë të sistemit arsimor francez me kuadrin arsimor shqiptar. Ky institucion pritet të kontribuojë në rritjen e cilësisë së arsimit parauniversitar, në zgjerimin e mundësive arsimore për nxënësit dhe në forcimin e lidhjeve arsimore dhe kulturore ndërmjet Shqipërisë dhe Francës.

Propozimi për këtë projektligj vjen edhe në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga ligji kuadër nr. 64/2024 “Për ratifikimin e Marrëveshjes Ndërqeveritare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Francës për kontributin në zbatimin e projekteve prioritare në Shqipëri” ku përcaktohet angazhimi për identifikimin dhe zbatimin e projekteve prioritare strategjike

në sektorë të ndryshëm përfshirë turizmin, menaxhimin e ujit, mjedisin, inovacionin, digjitalizimin, energjinë, reformën në administratën publike, transportin, arsimin, shëndetësinë dhe bujqësinë, që ka në si qëllim e transferimin e teknologjisë dhe zhvillimin profesional të fuqisë punëtore, që do të kontribuojë në përgatitjen e Shqipërisë për anëtarësimin në BE. Palët për arritjen e këtij qëllimi do të ndajnë informacionin përkatës për këto projekte dhe do të identifikojnë financimin për të mbështetur zbatimin e tyre.

Konkretisht në nenin 2 të këtij ligji përcaktohen mënyrat prioritare të bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Francës për kontributin në zbatimin e projekteve prioritare në Shqipëri siç janë nxitja e bashkëpunimit në fushën e arsimit parauniversitar, përfshirë arsimin dhe formimin profesional (VET/AFP), arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor; nxitja për hapjen dhe funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitar franceze në Republikën e Shqipërisë, institucioneve franceze të arsimit të lartë ose të degëve të tyre, modalitetet e organizimit dhe veprimtarisë e të cilave do të përcaktohen në aktet përkatëse të hapjes, ku sipas rastit do të ndiqen procedurat e brendshme të ratifikimit, bazuar në legjislacionin në fuqi, duke përfshirë hapjen e programeve të përbashkëta të studimit në institucionet përkatëse të arsimit të lartë të të dyja vendeve.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave*

Natyra e problemit, shkaqet e problemit dhe shtrirja e tij.

Problemet që mund të evidentohen janë:

- Mungesa e një institucioni arsimor publik i arsimit të mesëm të lartë që garanton aftësi të thella të nxënësve në shkenca dhe inovacion duke përfunduar njëkohësisht zotërimin e ekuilibruar të disa gjuhëve të huaja, si dhe duke garantuar një përgatitje optimale për arritjen e standardeve ndërkombëtare në arsimin e mesëm të lartë dhe tregun ndërkombëtar të punës.
- Mungesa e një bashkëpunimi ndërkombëtar në arsim përmes partneriteteve me shkolla dhe universitete franceze dhe programeve të përbashkëta.

- Mungesa e një modeli modern dhe inovativ të arsimit parauniversitar në Shqipëri, një institucion që promovon metoda bashkëkohore të mësimdhënies dhe përdorimin e teknologjisë.
- Mungesa e cilësisë së ofrimit të një arsimit shumëgjuhësh dhe ndërkombëtar të të nxënësve.
- Pamundësia e ofrimit nga shkollat shqiptare të një diplome të dyfishtë e njohur ndërkombëtarisht. Do të mundësohet një certifikim i dyfishtë, duke u ofruar nxënësve mundësinë të pajisen njëkohësisht me Diplomën e Maturës Shtetërore shqiptare dhe me diplomën franceze Baccalauréat, e njohur në një numër të madh vendesh.
- Proces i vështirë për akses të nxënësve në universitete prestigjioze ndërkombëtare dhe në programe studimi jashtë vendit.
- Mungesa e efikasitetit në bashkëpunimin ndërinstitucional.

Grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.

Qeveria:

Krijimi i Liceut Francez të Korçës, i orientuar në shkencë dhe inovacion, mbështet politikën e qeverisë për ndërkombëtarizimin e arsimit parauniversitar, rritjen e cilësisë së arsimit dhe zhvillimin e kapitalit njerëzor në fushat STEM. Në mungesë të një institucioni të tillë, mundësitë për ofrimin e një arsimit të avancuar me standarde ndërkombëtare në këto fusha mbeten të kufizuara, duke ndikuar në konkurrueshmërinë e sistemit arsimor shqiptar dhe në aftësinë e tij për të përgatitur të rinj të kualifikuar për ekonominë e dijes dhe inovacionit. Krijimi i këtij liceu përforcon gjithashtu bashkëpunimin arsimor ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Franceze.

Shoqëria civile:

Shoqëria civile, veçanërisht organizatat që veprojnë në fushën e arsimit, rinisë dhe inovacionit, kanë interes në zhvillimin e modeleve të reja arsimore që nxisin cilësinë, meritokracinë dhe orientimin drejt shkencës. Krijimi i këtij liceu do të ofrojë një model të avancuar të arsimit të mesëm, i cili mund të shërbejë si praktikë e mirë për zhvillimin e programeve të reja mësimore dhe për promovimin e kulturës së kërkimit, teknologjisë dhe inovacionit tek të rinjtë. Gjithashtu, shoqëria civile do të ketë mundësi të bashkëpunojë me institucionin në aktivitete edukative, projekte kërkimore dhe iniciativa që lidhen me zhvillimin e komunitetit.

Qytetarët:

Vendosja e një institucioni elitari arsimor jashtë kryeqytetit kontribuon në balancimin territorial të zhvillimit të arsimit cilësor në Shqipëri. Kjo politikë ndihmon në fuqizimin e qendrave rajonale si Korça dhe krijon mundësi të barabarta për nxënësit nga rajone të ndryshme të vendit për të ndjekur programe të avancuara arsimore. Nxënësit e arsimit bazë që synojnë të ndjekin studime të avancuara në fushat e

shkencës, teknologjisë dhe inovacionit janë ndër përfituesit kryesorë. Krijimi i liceut u ofron atyre mundësinë të ndjekin një program arsimor të avancuar, me komponent ndërkombëtar dhe me orientim të fortë drejt shkencave dhe inovacionit, duke rritur mundësitë për vazhdimin e studimeve në universitete prestigjioze brenda dhe jashtë vendit. Pozicioni gjeografik i Korçës, pranë kufijve me vende të tjera të rajonit, krijon potencial për të tërhequr nxënës edhe nga rajoni dhe për të zhvilluar një institucion arsimor me dimension ndërkombëtar, të orientuar drejt shkencës, teknologjisë dhe inovacionit.

Edhe familjet e nxënësve përfitojnë nga një ofertë arsimore cilësore dhe konkurruese brenda vendit, duke reduktuar nevojën për të kërkuar alternativa arsimore jashtë Shqipërisë. Krijimi i këtij institucioni kontribuon gjithashtu në zhvillimin arsimor dhe kulturor të qytetit të Korçës dhe të rajonit përreth.

Biznesi:

Sektori privat, veçanërisht kompanitë që operojnë në fushat e teknologjisë, inxhinierisë, kërkimit dhe inovacionit, përfitojnë në afatgjatë nga përgatitja e një brezi të ri nxënësish me kompetenca të avancuara në shkencë dhe teknologji. Liceu mund të krijojë mundësi bashkëpunimi me biznesin përmes projekteve inovative, praktikave mësimore, aktiviteteve kërkimore dhe zhvillimit të aftësive që kërkon tregu i punës. Në këtë mënyrë kontribuohet në forcimin e lidhjes ndërmjet arsimit dhe ekonomisë, si dhe në krijimin e një baze më të fortë të kapitalit njerëzor për zhvillimin ekonomik të vendit.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë*

Propozimi për këtë nismë vjen edhe në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga ligji kuadër nr. 64/2024 “Për ratifikimin e Marrëveshjes Ndërqeveritare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Francës për kontributin në zbatimin e projekteve prioritare në Shqipëri” ku përcaktohet angazhimi për identifikimin dhe zbatimin e projekteve prioritare strategjike në sektorë të ndryshëm përfshirë turizmin, menaxhimin e ujit, mjedisin, inovacionin, digjitalizimin, energjinë, reformën në administratën publike, transportin, arsimin, shëndetësinë dhe bujqësinë, që kanë si qëllim transferimin e teknologjisë dhe zhvillimin profesional të

fuqisë punëtore, që do të kontribuojë në përgatitjen e Shqipërisë për anëtarësimin në BE. Palët për arritjen e këtij qëllimi do të ndajnë informacionin përkatës për këto projekte dhe do të identifikojnë financimin për të mbështetur zbatimin e tyre.

Konkretisht në nenin 2 të këtij ligji përcaktohen mënyrat prioritare të bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Francës për kontributin në zbatimin e projekteve prioritare në Shqipëri siç janë nxitja e bashkëpunimit në fushën e arsimit parauniversitar, përfshirë arsimin dhe formimin profesional (VET/AFP), arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor; nxitja për hapjen dhe funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitar franceze në Republikën e Shqipërisë, institucioneve franceze të arsimit të lartë ose të degëve të tyre, modalitetet e organizimit dhe veprimtarisë e të cilave do të përcaktohen në aktet përkatëse të hapjes, ku sipas rastit do të ndiqen procedurat e brendshme të ratifikimit, bazuar në legjislacionin në fuqi, duke përfshirë hapjen e programeve të përbashkëta të studimit në institucionet përkatëse të arsimit të lartë të të dyja vendeve.

Në Strategjinë Kombëtare të Arsimit, 2021-2026, të miratuar me vendimin nr. 621, datë 22.10.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Arsimit, 2021-2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj” (SKA 2021-2026) përcaktohet vizioni i saj që është ndërtimi i një sistemi arsimor cilësor i bazuar në parimet e gjithëpërfshirjes dhe të të mësuarit gjatë të gjithë jetës, që mundëson zhvillimin e potencialit të individit, duke kontribuar në mirëqenien personale të tij, si dhe në forcimin e demokracisë dhe integrimin e vendit në Bashkimin Evropian.

Ky vizion është zberthyer në tri qëllime të politikave, si më poshtë:

Nwprwmjet kwsaj nisme qeveria synon:

Arsim parauniversitar cilësor, gjithëpërfshirës dhe i barabartë që krijon kushte që të gjithë nxënësit, pa asnjë dallim, të zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera në pajtim me kërkesat e shoqërisë demokratike, të përballen në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës, si dhe të kontribuojnë në ndërtimin e mirëqenies vetjake dhe të shoqërisë.

Menaxhim efektiv dhe eficient i sistemit të arsimit në të gjitha nivelet, i bazuar në mekanizma funksionale për sigurimin e cilësisë, transparencës dhe llogaridhënies.

Arsim i lartë gjithëpërfshirës që plotëson standardet ndërkombëtare të cilësisë, integritetit akademik e transparencës dhe është promotor i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit.

Në zërthimin e qëllimit të politikës A, që ka si qëllim strategjik ngritjen e një sistemi arsimor cilësor dhe të bazuar në parimet e gjithëpërfshirjes dhe mësimit gjatë të gjithë jetës, që mundëson zhvillimin e të gjithë individëve deri në kufijtë e potencialit të plotë të tyre, duke kontribuar në mirëqenien personale të tyre, si dhe në forcimin e demokracisë dhe integrimin e vendit në Bashkimin Evropian. Përcaktohen objektivat që duhet të përmbushen si vijon:

Objektivi specifik A.1: Sigurimi i gjithëpërfshirjes dhe pjesëmarrjes në klasën përgatitore dhe arsimin e detyruar, si dhe rritja e aksesit në arsimin parashkollor dhe në arsimin e mesëm të lartë;

Objektivi specifik A.2: Sigurimi i mirëqenies sociale, emocionale dhe fizike të të gjithë nxënësve për të ulur braktisjen dhe për t'u mundësuar nxënësve të arrijnë potencialin e tyre të plotë;

Objektivi specifik A.3: Krijimi i mundësive për formimin cilësor të mësuesve dhe përmirësimi i sistemit të karrierës që i inkurajon të zhvillojnë nivele më të larta të aftësive për mësimdhënie;

Objektivi specifik A.4: Zbatimi i plotë i kurrikulës së bazuar në kompetenca, nëpërmjet mësimdhënies efektive dhe shfrytëzimit të burimeve të cilësisë së lartë;

Objektivi specifik A.5: Zhvillimi i kompetencës digjitale, nëpërmjet shfrytëzimit më të mirë të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për mësimdhënie dhe të nxënë.

Qëllimi i politikës B ka të bëjë me menaxhimin e sistemit të arsimit dhe zërthehet në dy objektiva specifikë:

Objektivi specifik B.1: Rritja e performancës së shkollës, nëpërmjet drejtimit dhe menaxhimit profesional e të përgjegjshëm dhe sigurimit të cilësisë;

Objektivi specifik B.2: Garantimi i performancës së sistemit të arsimit nëpërmjet ndërtimit të një kornize gjithëpërfshirëse të vlerësimit dhe kapaciteteve për zbatimin e saj.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifikë, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë*

Ky propozim synon të krijojë një Liceun Francez të shkencës dhe inovacionit

Objektivat e tij kryesorë janë:

1. Zhvillimi i kompetencave në shkencë, inovacion dhe gjuhë të huaja

Të zhvillohen aftësitë e nxënësve në shkencë, inovacion dhe gjuhë të huaja duke synuar që të paktën 60% e nxënësve të arrijnë nivelin B2 në një gjuhë të huaj dhe 50% të arrijnë nivelin B1 në një gjuhë të dytë, si dhe shumica e nxënësve të përfshihen në projekte STEM ose aktivitete inovative gjatë ciklit të arsimit të mesëm.

2. Ndërtimi i partneriteteve ndërkombëtare në arsim

Të krijohen dhe zhvillohen të paktën 3 partneritete aktive me shkolla dhe universitete franceze brenda 5 viteve, si dhe të realizohen të paktën 3 programe të përbashkëta akademike ose projekte shkëmbimi çdo vit për nxënësit dhe mësuesit.

3. Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies

Të sigurohen standarde të larta pedagogjike duke garantuar që 100% e stafit pedagogjik të trajnohet të paktën një herë në vit në metoda moderne të mësimdhënies dhe që të paktën 70% e mësuesve të aplikojnë metoda interaktive dhe teknologji digjitale në procesin mësimor.

4. Forcimi i kompetencave në STEM

Të zhvillohen kompetencat e nxënësve në matematikë, shkencë natyrore, teknologji dhe inovacion duke synuar që mbi 50% e nxënësve të arrijnë rezultate mbi mesataren kombëtare në lëndët STEM dhe të paktën 30% e maturantëve të zgjedhin studime universitare në fusha STEM.

5. Forcimi i bashkëpunimit arsimor dhe kulturor Shqipëri–Francë

Të realizohen të paktën 2 aktivitete të përbashkëta kulturore dhe akademike në vit me institucione franceze dhe të përfshihen të paktën 30 nxënës dhe 5 mësues çdo vit në programe shkëmbimi, vizita studimore ose projekte të përbashkëta.

6. Krijimi i një modeli modern dhe inovativ të arsimit parauniversitar

Të zhvillohet një institucion arsimor që përdor metoda bashkëkohore dhe teknologji digjitale duke siguruar që 100% e klasave të jenë të pajisura me mjete digjitale të mësimdhënies dhe që të paktën 30% e kurrikulës të përfshijë projekte praktike ose ndërdisiplinore.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura*

2. **Opsioni 0:** – status quo-ja. Të vijohet me kuadrin ligjor ekzistues, ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Pra ruajtja e “status quo”-së (duke mosndërhur me amendime të mëtejshme, në kuadrin ligjor në fuqi dhe duke mos hartuar një projektligj të ri) nuk do të sigurojë një qasje rajonale dhe ndërkombëtare, duke zhvilluar partneritete arsimore, kulturore, shkencore franko-shqiptare, si dhe të vazhdojë traditën e bashkëpunimit arsimor frankofon të Liceut të Korçës. Ngritja e një institucioni arsimor publik në bazë të ligjit në fuqi nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar nuk do të garantonte autonomi administrative dhe financiare, siç synohet të ketë Liceu Francez i Korçës.

Nëse zgjidhet ky opsion, nuk do të ketë mundësi për ngritjen dhe funksionimin e Liceut Francez të Korçës, duke ruajtur varësinë nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe duke vazhduar funksionimin sipas dispozitave ekzistuese. Status quo-ja nuk adreson sfidat e identifikuar në raport me efikasitetin, cilësinë dhe autonominë institucionale dhe nuk krijon hapësirë për zhvillim të mëtejshëm ekonomik, organizativ apo për përmirësim të performancës institucionale.

Kjo alternativë konsiston në krijimin e një programi të specializuar shkencor dhe dygjuhësh brenda një gjimnazi ekzistues publik, duke përdorur infrastrukturën dhe strukturën administrative të institucionit aktual. Avantazhi kryesor i kësaj alternative lidhet me kostot më të ulëta fillestare, pasi nuk kërkohet krijimi i një institucioni të ri dhe mund të përdoret infrastruktura ekzistuese shkollore. Në këtë mënyrë do të reduktoheshin investimet fillestare për pajisje dhe mobilim, si dhe një pjesë e kostove administrative. Megjithatë, analiza tregon se kjo alternativë ka disa kufizime të rëndësishme strukturore.

Avantazhet e Opsionit 0:

- Nuk kërkon ndryshime ligjore;
- Kostot më të ulëta fillestare, pasi nuk kërkohet krijimi i një institucioni të ri dhe mund të përdoret infrastruktura ekzistuese shkollore. Në këtë mënyrë do të reduktoheshin investimet fillestare për pajisje dhe mobilim, si dhe një pjesë e kostove administrative. Megjithatë, analiza tregon se kjo alternativë ka disa kufizime të rëndësishme strukturore.

Disavantazhet:

- Ka kosto financiare për ngritjen dhe funksionimin e Liceut brenda një shkolle ekzistuese;
- Nuk do të ketë mundësi për ngritjen dhe funksionimin e Liceut Francez të Korçës, duke ruajtur varësinë nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe duke vazhduar funksionimin sipas dispozitave ekzistuese. Status quo-ja nuk adreson sfidat e identifikuara në raport me efikasitetin, cilësinë dhe autonominë institucionale dhe nuk krijon hapësirë për zhvillim të mëtejshëm ekonomik, organizativ apo për përmirësim të performancës institucionale.
- Nuk ka fleksibilitetin institucional për të implementuar një model të plotë ndërkombëtar të arsimit të mesëm. Integrimi i një programi të avancuar dygjuhësh në një strukturë ekzistuese mund të krijojë vështirësi organizative dhe pedagogjike.
- Infrastruktura e gjimnazeve aktuale nuk është projektuar për modele të avancuara laboratorike dhe teknologjike, të cilat janë një komponent thelbësor i projektit të liceut. Për pasojë, do të kërkoreshin ndërhyrje të konsiderueshme në infrastrukturë dhe pajisje, të cilat do të reduktonin ndjeshëm avantazhin financiar fillestar të kësaj alternative.
- Integrimi i një programi ndërkombëtar në një institucion ekzistues do të kufizonte autonominë akademike dhe administrative të programit dhe do të vështirësonte bashkëpunimin institucional me partnerët ndërkombëtarë.
- Nuk garanton krijimin e një modeli të plotë dhe të qëndrueshëm të arsimit ndërkombëtar të mesëm.

Opsioni 1: – Ndryshimi i kuadrit rregullator në fuqi për të krijuar mundësinë e ngritjes dhe funksionimit të Liceut Francez të Korçës. Ndryshimi i kuadrit rregullator ekzistues nuk do të sillte mundësinë e krijimit të Liceut Francez të Korçës. Mënyra e saj e re konceptuale e organizimit dhe funksionimit të Liceut Francez të Korçës duhet të jetë e rregulluar me një ligj të posaçëm, me qëllim krijimin e një modeli modern dhe inovativ të arsimit parauniversitar në Shqipëri, një institucion që promovon metoda bashkëkohore të mësimdhënies dhe përdorimin e teknologjisë, që përcjell një mënyrë të re organizimi, administrimi dhe financimi.

Avantazhet e Opsionit 1:

- Mund të zbatohet më shpejt dhe me procedura më të thjeshta administrative, pa kaluar në procesin e plotë të miratimit të një ligji të ri;
- Ka kosto më të ulët ligjore dhe institucionale, pasi ndryshimet bëhen brenda kuadrit aktual normativ;
- Lejon përshtatje të pjesshme të mundësisë së krijimit të Liceut Francez të Korçës.

Disavantazhet:

- Ndryshimet në aktet ekzistuese nuk garantojnë mundësinë e krijimit të Liceut Francez të Korçës;
- Pamundësia e krijimit të një modeli modern dhe inovativ të arsimit parauniversitar në Shqipëri, një institucion që promovon metoda bashkëkohore të mësimdhënies dhe përdorimin e teknologjisë, që përcjell një mënyrë të re organizimi, administrimi dhe financimi;

Ky opsion nuk e realizon qëllimin kryesor të ngritje dhe funksionimit të Liceut me një qasje të re moderne të mësimdhënies-nxënies, përvetësimin të njohurive të thella në STEM të nxënësve etj.

Opsioni 2 (i preferuar): – Alternativa e tretë konsiston në ngritjen dhe funksionimin e një institucioni të ri publik, Liceut Francez të Korçës, i cili do të funksionojë si një shkollë e specializuar me profil shkencor dhe me model pedagogjik dygjuhësh.

Kjo alternativë mundëson ndërtimin e një strukture institucionale të dedikuar për realizimin e objektivave të projektit dhe garanton një organizim të pavarur pedagogjik dhe administrativ.

Një institucion i ri lejon krijimin e një modeli të integruar arsimor që përfshin laboratorë të avancuar shkencorë, hapësira inovacioni dhe një strukturë pedagogjike të orientuar drejt fushave STEM. Gjithashtu, kjo alternativë krijon kushte më të favorshme për bashkëpunim institucional me partnerët ndërkombëtarë dhe për integrimin e praktikave pedagogjike të sistemit arsimor francez.

Nga pikëpamja financiare, kjo alternativë kërkon investime më të mëdha fillestare dhe një nivel më të lartë të kostove operative në krahasim me alternativën e integrit të programit në një gjimnaz ekzistues. Megjithatë, analiza tregon se këto kosto lidhen drejtpërdrejt me standardin e lartë të arsimit që synon të ofrojë institucioni dhe me komponentët ndërkombëtarë të programit.

Gjithashtu, krijimi i një institucioni të ri mundëson zhvillimin e një modeli pilot për arsimin shkencor dhe inovativ në Shqipëri, i cili mund të shërbejë si referencë për zhvillimin e politikave të ardhshme në sistemin arsimor.

Nga analiza e kryer rezultojnë se alternativa e krijimit të një institucioni të ri publik me model ndërkombëtar paraqet potencialin më të madh për realizimin e objektivave të projektit dhe për zhvillimin e një modeli të qëndrueshëm të arsimit të mesëm me standarde ndërkombëtare në Shqipëri. Megjithatë kjo alternativë kërkon një nivel më të lartë investimi fillestar dhe kostosh operative, përfitimet

afatgjata në aspektin e cilësisë së arsimit, bashkëpunimit ndërkombëtar dhe zhvillimit të kapaciteteve shkencore e bëjnë atë alternativën më të përshtatshme për realizimin e objektivave të projektligjit.

Nga analiza rezulton se **alternativa e tretë** ofron potencialin më të madh për arritjen e objektivave strategjike të projektit.

Analiza financiare parashikon një rritje progresive të kostove **gjatë pesë viteve të para** të funksionimit të institucionit.

Avantazhet:

- Mundëson ndërtimin e një strukture institucionale të dedikuar për realizimin e objektivave të projektit dhe garanton një organizim të pavarur pedagogjik dhe administrativ;
- Krijimin e një modeli të integruar arsimor që përfshin laboratorë të avancuar shkencorë, hapësira inovacioni dhe një strukturë pedagogjike të orientuar drejt fushave STEM. Kushte më të favorshme për bashkëpunim institucional me partnerët ndërkombëtarë dhe për integrimin e praktikave pedagogjike të sistemit arsimor francez;
- Krijimi i një institucioni të ri mundëson zhvillimin e një modeli pilot për arsimin shkencor dhe inovativ në Shqipëri, i cili mund të shërbejë si referencë për zhvillimin e politikave të ardhshme në sistemin arsimor;
- Krijimi i një institucioni të ri publik me model ndërkombëtar paraqet potencialin më të madh për realizimin e objektivave të projektit dhe për zhvillimin e një modeli të qëndrueshëm të arsimit të mesëm me standarde ndërkombëtare në Shqipëri.

Disavantazhet:

- Kërkon kohë dhe burime njerëzore për hartimin, miratimin dhe zbatimin e ligjit të ri.
- Ka kosto fillestare shtesë për ngritjen dhe funksionimin e Liceut.

Ky opsion është i preferuar kundrejt opsioneve të tjera për arsyt si më poshtë vijon:

- Në ndryshim nga opsioni 0 (status quo-ja), ky opsion jep mundësinë e krijimit të një institucioni arsimor parauniversitar publik me model të ri, modern inovativ në përfitim të kompetencave të nxënies nga nxëniesit.
- Në krahasim me opsionin 1 (ndryshimi i kuadrit ekzistues), ky opsion garanton krijimin e një strukture institucionale të dedikuar për realizimin e objektivave të projektit dhe garanton një organizim të pavarur pedagogjik dhe administrativ.
- Kështu, miratimi i ligjit të posaçëm është alternativa më e efektshme për të përmbushur objektivat strategjike ngritjes dhe

funksionimit të Liceut.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).*
 - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
 - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
 - *Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.*
 - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
- *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*
 - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*

- *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuar krahasohen me njëra-tjetrën.*
- *Paraqisni përlllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opSION (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).*

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Vlerësimi Cilësor i Ndikimeve të Opsionit të Preferuar:

Kjo alternativë mundëson ndërtimin e një strukture institucionale të dedikuar për realizimin e objektivave të projektit dhe garanton një organizim të pavarur pedagogjik dhe administrativ.

Një institucion i ri lejon krijimin e një modeli të integruar arsimor që përfshin laboratorë të avancuar shkencorë, hapësira inovacioni dhe një strukturë pedagogjike të orientuar drejt fushave STEM. Gjithashtu, kjo alternativë krijon kushte më të favorshme për bashkëpunim institucional me partnerët ndërkombëtarë dhe për integrimin e praktikave pedagogjike të sistemit arsimor francez.

Gjithashtu, krijimi i një institucioni të ri mundëson zhvillimin e një modeli pilot për arsimin shkencor dhe inovativ në Shqipëri, i cili mund të shërbejë si referencë për zhvillimin e politikave të ardhshme në sistemin arsimor.

Nga analiza e kryer rezulton se alternativa e krijimit të një institucioni të ri publik me model ndërkombëtar paraqet potencialin më të madh për realizimin e objektivave të projektit dhe për zhvillimin e një modeli të qëndrueshëm të arsimit të mesëm me standarde ndërkombëtare në Shqipëri. Megjithatë kjo alternativë kërkon një nivel më të lartë investimi fillestar dhe kostosh operative, përfitimet afatgjata në aspektin e cilësisë së arsimit, bashkëpunimit ndërkombëtar dhe zhvillimit të kapaciteteve shkencore e bëjnë atë alternativën më të përshtatshme për realizimin e objektivave të projektligjit.

1. Ndikimet ekonomike dhe financiare

Nga pikëpamja financiare, kjo alternativë kërkon investime më të mëdha fillestare dhe një nivel më të lartë të kostove operative në krahasim me alternativën e integritit të programit në një gjimnaz ekzistues. Megjithatë, analiza tregon se këto kosto lidhen drejtpërdrejt me standardin e lartë të arsimit që synon të ofrojë institucioni dhe me komponentët ndërkombëtarë të programit.

2. Ndikimet sociale

Ndikimet sociale prekin të gjitha grupet e interesuara:

Ndikimet sociale të këtij ligji lidhen me përmirësimin e rezultateve të nxënësve dhe zgjerimin e mundësive për studentët e ardhshëm të kontribuojnë drejtpërdrejt në krijimin e kushteve më të mira për zhvillimin ekonomik të vendit, me ndikime pozitive në aspektin socio-ekonomik. Institucioni pritet të kontribuojë gjithashtu në zhvillimin ekonomik dhe social të rajonit ku do të vendoset, duke krijuar vende pune dhe duke rritur atraktivitetin akademik të zonës.

Ndikimet institucionale dhe administrative

Opsioni i preferuar sjell një ndryshim strukturor sa më poshtë:

- Kalim nga model i centralizuar në një model autonom e vetërregullues;
- Ristrukturim i qartë i funksioneve për planifikim, analizë dhe raportim;
- Rritje e llogaridhënies dhe transparencës institucionale;
- Krijim i bazës për **certifikim ndërkombëtar ISO9001** brenda 2–3 viteve.

Ky vlerësim cilësor përforcon përfundimin se Opsioni 2 është më i favorshmi ekonomikisht dhe socialisht, duke ofruar efikasitet, transparencë dhe qëndrueshmëri të lartë institucionale në ofrimin e shërbimeve arsimore.

Opsioni 2 (i preferuar): – Opsioni i preferuar është përzgjedhur opsioni 2, i cili konsiston në ngritjen dhe funksionimin e një institucioni të ri publik, Liceut Francez të Korçës, i cili do të funksionojë si një shkollë e specializuar me profil shkencor dhe me model pedagogjik dygjuhësh.

Kjo alternativë mundëson ndërtimin e një strukture institucionale të dedikuar për realizimin e objektivave të projektit dhe garanton një organizim të pavarur pedagogjik dhe administrativ.

Një institucion i ri lejon krijimin e një modeli të integruar arsimor që përfshin laboratorë të avancuar shkencorë, hapësira inovacioni dhe një strukturë pedagogjike të orientuar drejt fushave STEM. Gjithashtu, kjo alternativë krijon kushte më të favorshme për bashkëpunim institucional me partnerët ndërkombëtarë dhe për integrimin e praktikave pedagogjike të sistemit arsimor francez.

Nga pikëpamja financiare, kjo alternativë kërkon investime më të mëdha fillestare dhe një nivel më të lartë të kostove operative në krahasim me alternativën e integrit të programit në një gjimnaz ekzistues. Megjithatë, analiza tregon se këto kosto lidhen drejtpërdrejt me standardin e lartë të arsimit që synon të ofrojë institucioni dhe me komponentët ndërkombëtarë të programit.

Gjithashtu, krijimi i një institucioni të ri mundëson zhvillimin e një modeli pilot për arsimin shkencor dhe inovativ në Shqipëri, i cili mund të shërbejë si referencë për zhvillimin e politikave të ardhshme në sistemin arsimor.

Nga analiza e kryer rezultojnë se alternativa e krijimit të një institucioni të ri publik me model ndërkombëtar paraqet potencialin më të madh për realizimin e objektivave të projektit dhe për zhvillimin e një modeli të qëndrueshëm të arsimit të mesëm me standarde ndërkombëtare në Shqipëri. Megjithatë kjo alternativë kërkon një nivel më të lartë investimi fillestar dhe kostosh operative, përfitimet afatgjata në aspektin e cilësisë së arsimit, bashkëpunimit ndërkombëtar dhe zhvillimit të kapaciteteve shkencore e bëjnë atë alternativën më të përshtatshme për realizimin e objektivave të projektligjit.

Nga analiza rezultojnë se **alternativa e tretë** ofron potencialin më të madh për arritjen e objektivave strategjike të projektit.

Për të dhënë një ide më të qartë të arsyeve së përzgjedhjes së Opsionit 2 si opsioni i preferuar për implementimin e politikës, është përgatitur analiza me shumë kriterë.

Opsionet që janë marrë në konsideratë për analizën me shumë kriterë janë:

Opsioni 0: – status quo-ja : - Të vijohet me kuadrin ligjor ekzistues, ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Opsioni 1: – Ndryshimi i kuadrit rregullator në fuqi për të krijuar mundësinë e ngritjes dhe funksionimit të Liceut Francez të Korçës.

Opsioni 2 (i preferuar): – Hartimi i një ligji të posaçëm për ngritjen dhe funksionimin e Liceut.

Për të vlerësuar opsionet duke përdorur analizën me shumë kritere, janë ndjekur hapat e mëposhtëm:

Janë përcaktuar kriteret që tregojnë arritjen e objektivave:

1. **Të zhvillohen kompetencat në lëndët STEM dhe inovacion**, për aftësimin e nxënësve për studime universitare në fusha shkencore dhe teknologjike, si dhe aftësimin për sfidat me tregun e punës;
2. **Të forcohet arsimi shumëgjuhësh dhe ndërkombëtarizimi i të nxënit, përmes një modeli arsimor shumëgjuhësh**, ku procesi mësimor zhvillohet në gjuhën shqipe, frënge dhe angleze;
3. **Të sigurohet një diplome e dyfishtë e njohur ndërkombëtarisht, duke lehtësuar aksesin e nxënësve në universitete prestigjioze ndërkombëtare dhe në programe studimi jashtë vendit**;
4. **Të fuqizohet lidhja e arsimit me tregun ndërkombëtar të punës, përmes zhvillimit të kompetencave të transferueshme dhe aftësive të avancuara që kërkohen në tregun global të punës**;
5. **Të sigurohet cilësi e lartë në procesin e mësimdhënie -nxënies**, në përputhje me praktikat më të mira të sistemeve arsimore shqiptare dhe franceze.
6. **Të forcohet bashkëpunimi arsimor dhe kulturor shqiptaro-francez**, përmes një modeli bashkëpunimi të qëndrueshëm institucional.

Është vendosur pesha e kriterëve sipas rëndësisë relative:

1. **Të zhvillohen kompetencat në lëndët STEM dhe inovacion**, për aftësimin e nxënësve për studime universitare në fusha shkencore dhe teknologjike, si dhe aftësimin për sfidat me tregun e punës: 5
2. **Të forcohet arsimi shumëgjuhësh dhe ndërkombëtarizimi i të nxënit, përmes një modeli arsimor shumëgjuhësh**, ku procesi mësimor zhvillohet në gjuhën shqipe, frënge dhe angleze: 4

3. **Të sigurohet një diplomë e dyfishtë e njohur ndërkombëtarisht**, duke lehtësuar aksesin e nxënësve në universitete prestigjioze ndërkombëtare dhe në programe studimi jashtë vendit: 5
4. **Të fuqizohet lidhja e arsimit me tregun ndërkombëtar të punës, përmes zhvillimit të kompetencave të transferueshme dhe aftësive të avancuara që kërkohen në tregun global të punës:** 4
5. **Të sigurohet cilësi e lartë në procesin e mësimdhënie -nxënies**, në përputhje me praktikat më të mira të sistemeve arsimore shqiptare dhe franceze: 4
6. **Të forcohet bashkëpunimi arsimor dhe kulturor shqiptaro-francez**, përmes një modeli bashkëpunimi të qëndrueshëm institucional: 3.

Pra, për të bërë dallimin e opsioneve nga njëra-tjetra dhe me qëllim përzgjedhjen e opsionit më të mirë secili kriter është vlerësuar me një peshë specifike vlerësuar nga 1-5; Gjithashtu, secili kriter në varësi të peshës së tij, është vlerësuar me pikë përkatëse sipas shkallës së preferencës për çdo opsion për secilin kriter nga 0-5 ku 0 përfaqëson opsionin më pak të preferuar dhe 5 atë më të preferuarin. Matrica e performancës:

<u>Kriteret</u>	<u>Pesha</u> <u>(Rëndësia</u> <u>relative)</u>	<u>Opsioni 0</u>		<u>Opsioni 1</u>		<u>Opsioni 2</u>	
		<u>Pikë</u>	<u>Vlera</u> <u>(=Pesha x</u> <u>pikë)</u>	<u>Pikë</u>	<u>Vlera</u> <u>(=Pesha x</u> <u>pikë)</u>	<u>Pikë</u>	<u>Vlera</u> <u>(=Pesha x</u> <u>pikë)</u>
1. Të zhvillohen kompetencat në lëndët STEM dhe inovacion , për aftësimin e nxënësve për studime universitare në fusha shkencore dhe teknologjike, si dhe aftësimin për sfidat me tregun e punës;	5	2	10	4	20	<u>5</u>	25

<p>Të forcohet arsimi shumëgjuhësh dhe ndërkombëtarizimi i të nxënit, përmes një modeli arsimor shumëgjuhësh, ku procesi mësimor zhvillohet në gjuhën shqipe, frënge dhe angleze;</p>	4	<u>1</u>	4	2	8	4	16
<p>Të sigurohet një diplomë e dyfishtë e njohur ndërkombëtarisht, duke lehtësuar aksesin e nxënësve në universitete prestigjioze ndërkombëtare dhe në programe studimi jashtë vendit;</p>	5	<u>0</u>	0	2	10	5	25
<p>Të fuqizohet lidhja e arsimit me tregun ndërkombëtar të punës, përmes zhvillimit të kompetencave të transferueshme dhe</p>	4	<u>1</u>	4	2	8	4	16

aftësive të avancuara që kërkohen në tregun global të punës;							
Të sigurohet cilësi e lartë në procesin e mësimdhënie -nxënies, në përputhje me praktikat më të mira të sistemeve arsimore shqiptare dhe franceze.	4	<u>2</u>	8	2	8	4	16
Të forcohet bashkëpunimi arsimor dhe kulturor shqiptaro-francez, përmes një modeli bashkëpunimi të qëndrueshëm institucional.	3	1	3	2	6	4	12
<u>Pikët totale për secilin opsion</u>	-	<u>29</u>	-	<u>60</u>			<u>110</u>

Analiza me shumë kriteret tregon se opsioni 2, hartimi i projektligjit “– Hartimi i një ligji të posaçëm për ngritjen dhe funksionimin e Liceut” është vlerësuar me më shumë pikë, për këtë arsye është përzgjedhur si opsion i preferuar.

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*
- *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*

Njësia që do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.

Njësia përgjegjëse për zbatimin e këtij opsioni do t'i takojë Ministrisë përgjegjëse për arsimin, e cila do të udhëheqë procesin e hartimit dhe miratimit të ligjit të posaçëm.

- **Pengesat e mundshme për zbatimin.** Hartimi i një ligji të posaçëm për ngritjen dhe funksionimin e Liceut mund të kërkojë më shumë kohë dhe kapacitete njerëzore, për shkak të mungesës së një institucioni arsimor publik i arsimit të mesëm të lartë që garanton aftësi të thella të nxënësve në shkencë dhe inovacion, duke përforcuar njëkohësisht zotërimin e ekuilibruar të disa gjuhëve të huaja, si dhe duke garantuar një përgatitje optimale për arritjen e standardeve ndërkombëtare në arsimin e mesëm të lartë dhe tregun ndërkombëtar të punës; mungesës së një bashkëpunimi ndërkombëtar në arsim përmes partneriteteve me shkolla dhe universitete franceze dhe programeve të përbashkëta; mungesës së një modeli modern dhe inovativ të arsimit parauniversitar në Shqipëri, një institucion që promovon metoda bashkëkohore të mësimdhënies dhe përdorimin e teknologjisë; mungesës së cilësisë së ofrimit të një arsimit shumëgjuhësh dhe ndërkombëtar të të nxënësve; mungesa e ofrimit nga shkollat shqiptare të një diplome të dyfishtë e njohur ndërkombëtarisht.

Kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit. Veprimtaria e Liceut Francez të Korçës do të organizohet në përputhje me ligjin për ngritjen dhe funksionimin e Liceut Francez, legjislacionin shqiptar në fuqi në fushën e arsimit dhe me marrëveshjet e bashkëpunimit arsimor ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Franceze, siç janë “Marrëveshja ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Zhvillimit Ndërkombëtar të Republikës së Francës, mbi bashkëpunimin në fushën e Arsimit Dygjuhësh” dhe “Marrëveshjes Ndërqeveritare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Franceze mbi kontributin në zbatimin e projekteve prioritare në Shqipëri”, e ratifikuar me ligjin nr. 64/2024 “Për ratifikimin e Marrëveshjes Ndërqeveritare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Francës për kontributin në zbatimin e projekteve prioritare në Shqipëri” Po ashtu, në Strategjinë Kombëtare të Arsimit, 2021-2026, të miratuar me vendimin nr. 621, datë 22.10.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Arsimit, 2021-2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj” (SKA 2021-2026) përcaktohet vizioni i saj që është

ndërtimi i një sistemi arsimor cilësor i bazuar në parimet e gjithëpërfshirjes dhe të të mësuarit gjatë të gjithë jetës, që mundëson zhvillimin e potencialit të individit, duke kontribuar në mirëqenien personale të tij, si dhe në forcimin e demokracisë dhe integrimin e vendit në Bashkimin Evropian.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre*

Në kuadër të autonomisë së institucionit, mbikëqyrja e funksionimit të përgjithshëm të Liceut Francez të Korçës, do të kryhet nga Këshilli Administrativ si organi vendimmarrës i Liceut, i cili garanton autonominë e institucionit, zbatimin e parimeve të ligjshmërisë, përgjegjësisë, mbikëqyrjes, paañësisë, objektivitetit dhe transparencës dhe kryesohet nga Ministri përgjegjës për arsimin i Republikës së Shqipërisë ose përfaqësuesi i autorizuar prej tij. Liceu Francez i Korçës do të raportojë periodikisht pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin mbi veprimtarinë e tij, duke përfshirë informacion mbi ecurinë e procesit mësimor, rezultatet e nxënësve dhe çështje të tjera që lidhen me cilësinë e shërbimit arsimor.

Institucionet përgjegjëse për monitorimin dhe inspektimin verifikojnë pajtueshmërinë e veprimtarisë së Liceut me kuadrin rregullator në fuqi, nëpërmjet kryerjes së proceseve të monitorimit dhe të inspektimit.

Kurrikula e zbatuar për lëndët e zhvilluara në gjuhën frënge mbikëqyret nga ministria franceze përgjegjëse për arsimin, ndërsa për lëndët që zhvillohen në gjuhë shqipe dhe angleze mbikëqyret nga institucioni përgjegjës për Sigurimin e Cilësisë së Arsimit Parauniversitar.

Veprimtaria financiare e Liceut i nënshtrohet auditimit dhe kontrollit administrativ e financiar nga autoritetet kompetente, përfshirë institucionet përgjegjëse për arsimin dhe financat publike, sipas legjislacionit në fuqi.

Për realizimin e qëllimeve të tij, Liceu Francez i Korçës bashkëpunon dhe bashkërendon veprimtarinë me ministrinë përgjegjëse për arsimin, institucionet arsimore, autoritetet vendore dhe partnerët ndërkombëtarë në fushën e arsimit.

Disa nga indikatorët e matshëm që mund të përdoren në të ardhmen për vlerësimin e objektivave, në funksion të mekanizmave të mbikëqyrjes dhe kontrollit institucional:

Fusha: Performanca Institucionale

Indikator 1: Përqindja e planeve mësimore të realizuara sipas kalendarit zyrtar të shkollës.
Qëllimi i matjes: Mat respektimin e planifikimit mësimor dhe efikasitetin në zbatimin e programit akademik.

Indikator 2: Numri dhe cilësia e raporteve vjetore të dorëzuara në afat, që lidhen me aktivitetin mësimor, dhe administrativ.
Qëllimi i matjes: Mat respektimin e afateve dhe standardeve të raportimit ndaj MA, AKAP, DRAP, Ambasadës Franceze dhe institucioneve partnere.

Indikator 3: Përqindja e objektivave strategjike të përmbushur sipas planit vjetor të zhvillimit të institucionit.
Qëllimi i matjes: Tregon efektivitetin e planifikimit dhe zbatimit të strategjisë institucionale për vitin shkollor.

Fusha: Cilësia e Shërbimeve Arsimore

Indikator 1: Kënaqësia e prindërve dhe nxënësve për cilësinë e mësimdhënies dhe shërbimeve jashtëkurrikulare.
Qëllimi i matjes: Reflekton perceptimin e komunitetit shkollor mbi cilësinë e mësimdhënies dhe mbështetjes edukative.

Indikator 2: Numri i nismave të ndërmarra për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, përfshirë trajnime, aktivitete pedagogjike, dhe projekte

Qëllimi i matjes: Tregon angazhimin e stafit për zhvillim profesional dhe përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë arsimore.

Fusha: Transparenca dhe Llogaridhënia

Indikator 1: Publikimi periodik i informacionit në faqen zyrtare ose në kanalet e komunikimit të Liceut (planifikime, njoftime, raportime).

Qëllimi i matjes: Siguron transparencë, akses publik në informacion dhe ndërtim besimi me komunitetin.

Indikator 2: Përqindja e kërkesave për raportim të përmbushura ndaj institucioneve mbikëqyrëse shqiptare dhe franceze.

Qëllimi i matjes: Mat përputhshmërinë ligjore dhe bashkëpunimin ndërinstitutional në menaxhimin e aktivitetit.

Fusha: Ndikimi në Sistemin Arsimor dhe Komunitetin Lokal

Indikator 1: Numri i bashkëpunimeve dhe projekteve të përbashkëta me shkolla të tjera shqiptare dhe franceze.
Qëllimi i matjes: Mat kontributin e Liceut në zhvillimin e shkëmbimeve kulturore dhe arsimore franko-shqiptare.

Indikator 2: Rritja e përfshirjes së nxënësve në konkurse, olimpiada, projekte ndërkombëtare dhe aktivitete qytetare.
Qëllimi i matjes: Pasqyron ndikimin pozitiv të Liceut në zhvillimin akademik dhe social të nxënësve.

Fusha: Zhvillimi Institucional

Indikator 1: Numri i trajnimeve të stafit pedagogjik dhe administrativ në kuadër të zhvillimit profesional dhe ndërkulturor.
Qëllimi i matjes: Mat rritjen e kapaciteteve profesionale dhe përputhjen me standardet franceze të arsimit.

Indikator 2: Numri i partneriteteve kombëtare dhe ndërkombëtare të krijuara me institucione arsimore, kulturore dhe shkencore.
Qëllimi i matjes: Pasqyron bashkëpunimin dhe hapjen institucionale të Liceut drejt zhvillimit të qëndrueshëm.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuara në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

Nga analiza rezulton se **alternativa e tretë** ofron potencialin më të madh për arritjen e objektivave strategjike të projektit.

Analiza financiare parashikon një rritje progresive të kostove **gjatë pesë viteve të para** të funksionimit të institucionit.

Tregues kryesorë

Treguesi	Vlera
Kapaciteti maksimal i liceut	360 nxënës
Numri i klasave	12 klasa
Kosto mesatare për nxënës	rreth 8,800 € / vit
Kosto mesatare për klasë	rreth 266,000 € / vit
Kosto mesatare vjetore për buxhetin e shtetit (5 vitet e para)	rreth 2.15 milion €

Investimi fillestar

Zëri	Vlera e vlerësuar
Pajisje laboratorike dhe STEM	800,000 – 1,000,000 €
Pajisje digjitale dhe IT	300,000 – 400,000 €
Mobilim dhe pajisje pedagogjike	400,000 – 500,000 €

Zëri	Vlera e vlerësuar
Pajisje mediateke dhe hapësira inovacioni	200,000 – 400,000 €
Totali i investimit fillestar	1.7 – 2.3 milion €

Tabela e RIA – Ndikimi financiar i projektligjit

Viti	Numri i nxënësve	Kosto totale e projektit (€)	Kontributi i palës franceze (drejtori) (€)	Kosto neto për buxhetin e shtetit (€)	Kosto për nxënës (€)
Viti 1	120	1,123,143	115,200	1,007,943	8,399
Viti 2	200	1,675,852	117,000	1,558,852	7,794
Viti 3	280	2,574,031	118,800	2,455,231	8,769
Viti 4	320	2,761,221	120,600	2,640,621	8,252
Viti 5	360	3,197,204	122,500	3,074,704	8,541
Totali 5 vite	—	11,331,451	≈594,000	≈10,737,000	—

Krahasimi me një gjimnaz publik shqiptar

Tregues	Gjimnaz publik shqiptar	Liceu Franko-Shqiptar
Numri i nxënësve	360	360
Kosto vjetore totale	≈ 648,000 €	≈ 3,197,000 €
Kosto për nxënës	≈ 1,800 €	≈ 8,400 €
Kosto për klasë	≈ 54,000 €	≈ 266,000 €

Kostoja për nxënës në Liceun Francez të Korçës është rreth **4.5 – 5 herë më e lartë** se në një gjimnaz publik standard, për shkak të:

- modelit dygjuhësh dhe ndërkombëtar të arsimit,
- stafit pedagogjik ndërkombëtar,
- laboratorëve shkencorë dhe pajisjeve STEM,
- strukturës së zgjeruar pedagogjike dhe të jetës shkollore.

Investimi fillestar (RIA)

Kategoria	Vlera e vlerësuar
Pajisje laboratorike dhe STEM	800,000 – 1,000,000 €
Infrastrukturë digjitale dhe IT	300,000 – 400,000 €
Mobilim dhe pajisje pedagogjike	400,000 – 500,000 €
Pajisje për mediatekë dhe hapësira inovacioni	200,000 – 400,000 €
Totali investimit fillestar	1.7 – 2.3 milion €

Në këtë kuadër, projektligji parashikon që gjatë pesë viteve të para të funksionimit pala franceze të mbulojë kostot që lidhen me pozicionin e drejtorit të liceut, i cili parashikohet të jetë një drejtues me përvojë në sistemin arsimor francez. Kostoja e këtij pozicioni vlerësohet rreth **115 mijë euro në vit**, ose rreth **594 mijë euro në pesë vite**.

Në këtë mënyrë, kostoja neto për buxhetin e shtetit gjatë pesë viteve të para parashikohet të jetë rreth **10.74 milion euro**.

Përveç kostove operative, projekti kërkon edhe një investim fillestar për pajisjet dhe mobilimin e institucionit, i cili vlerësohet mesatarisht **2 milion euro**. Në buxhetin e Ministrisë përgjegjëse për arsimin për periudhën 2026-2028 janë planifikuar 100 milion lekë ose 1 milion euro (përkatesisht 200 mijë euro në buxhetin e vitit 2026 dhe 800 mijë euro në buxhetin e vitit 2027). Në vijim, pajisjet me infrastrukturë digjitale do të sigurohen përmes projektit “Gov tech”.

Gjithashtu në buxhetin e vitit 2026-2028 janë planifikuar edhe fondet për burimet njerëzore për palën shqiptare (pa kostot e mensës dhe konviktit të cilat përballohen nga NJQV, Bashkia Korçë), ku përfshihen paga, kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe shpenzime operative.

Krijimi i liceut nuk kërkon ngritjen e institucioneve të reja shtetërore, por krijimin e një institucioni arsimor publik në varësi të Ministrisë së Arsimit.

Institucioni do të funksionojë në bashkëpunim me:

- Ministrinë e Arsimit;
- institucionet arsimore franceze;
- partnerë që veprojnë në fushën e arsimit.

Projektligji pritet të ketë ndikime pozitive në disa drejtime:

- përmirësimi i cilësisë së arsimit të mesëm në fushat shkencore;
- rritja e mundësive të nxënësve shqiptarë për studime në universitetet europiane;
- zhvillimi i kapaciteteve pedagogjike dhe shkencore në sistemin arsimor shqiptar;
- rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e arsimit.

Institucioni pritet të kontribuojë gjithashtu në zhvillimin ekonomik dhe social të rajonit ku do të vendoset, duke krijuar vende pune dhe duke rritur atraktivitetin akademik të zonës.

Projektligji nuk krijon barriera për biznesin dhe nuk ndikon në konkurrencën në treg.

Kostot për buxhetin e shtetit shqiptar

Viti	Kosto bazë (€)	Kontributi francez (€)	Kosto neto (€)
1	1,123,143	115,200	1,007,943
2	1,675,852	115,200	1,560,652

Viti	Kosto bazë (€)	Kontributi francez (€)	Kosto neto (€)
3	2,574,031	115,200	2,458,831
4	2,761,221	115,200	2,646,021
5	3,197,204	115,200	3,082,004
6	3,249,130	115,200	3,133,930
7	3,249,130	115,200	3,133,930
8	3,249,130	115,200	3,133,930
9	3,249,130	115,200	3,133,930
10	3,249,130	115,200	3,133,930

Tabela NPV (diskontim 4%). Për qëllime të analizës financiare, kostot janë përlogaritur në **vlere aktuale neto**, duke përdorur një **normë diskontimi prej 4%**

Viti	Kosto neto (€)	Faktor diskontimi	Vlera aktuale (€)
1	1,007,943	0.962	969,600
2	1,560,652	0.925	1,444,000
3	2,458,831	0.889	2,186,000
4	2,646,021	0.855	2,261,000
5	3,082,004	0.822	2,533,000
6	3,133,930	0.790	2,474,000
7	3,133,930	0.760	2,382,000
8	3,133,930	0.731	2,290,000
9	3,133,930	0.703	2,203,000
10	3,133,930	0.676	2,118,000

Skenari	NPV 10 vite
Financim i plotë nga Shqipëria	≈ 27.8 milion €
Franca mbulon vetëm drejtorin	≈ 22.86 milion €

Kontributi i Francës për pagën e drejtorit:

115,200 € / vit

NPV e këtij kontributi në 10 vite:

≈ **4.9 milion €**

Pra barra buxhetore për Shqipërinë ulet me rreth:

4.9 milion € në 10 vite

Në skenarin ku pala franceze mbulon vetëm pagën e drejtorit të institucionit, vlera aktuale neto e kostove për buxhetin e shtetit për periudhën 10-vjeçare vlerësohet rreth **22.9 milion euro**, duke reduktuar barrën fiskale me rreth 4.9 milion euro krahasuar me skenarin e financimit të plotë nga buxheti i shtetit.